



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 1120/47 Prot.

Tiranë, më 29.12.2017

**VENDIM**

**Nr.255, datë 29.12.2017**

**PËR**

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT  
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 132, DATË 13.06.2017,  
NË INSTITUCIONIN E MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 132, datë 13.06.2017, “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në datën 12.06.2017, në lidhje me pezullimin nga shërbimi civil të punonjësës \*\*\*\*\*”,

**KONSTATOVA SE:**

Me Urdhrin nr. 1120 prot., datë 12.06.2017, ka nisur verifikimi i ligjshmërisë së veprimit administrativ përfunduar me Urdhrin Nr. 327, datë 09.06.2017, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për pezullimin nga detyra të Drejtores së Drejtorisë Arsimore Rajonale, Vlorë”. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr.132, datë 13.06.2017, “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në datën 12.06.2017, në lidhje me pezullimin nga shërbimi civil të punonjësës \*\*\*\*\*”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në pikën 1 të të cilit është vendosur:

“1. Të kërkoj nga Ministri i Arsimit dhe Sportit, që për të rregulluar situatën e ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, të anulojë Urdhrin nr. 327, datë 09.06.2017, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për pezullimin nga detyra të

*Drejtores së Drejtorisë Arsimore Rajonale, Vlorë”, si një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm , duke rikthyer në detyrën e Drejtores së Drejtorisë Arsimore Vlorë, punonjësen \*\*\*\*\*.”*

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmërues Nr. 132, datë 13.06.2017, “*Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në datën 12.06.2017, në lidhje me pezullimin nga shërbimi civil të punonjëses \*\*\*\*\*”*, ka vendosur fillimin e verifikimit të zbatimit të këtij vendimi.

Për këtë qëllim u ngrit grupi i punës, me përbërje Enkelejda Hebibasi, Drejtor i Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë dhe Migena Haznedari, Specialiste në Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, të cilët në datën 04.12.2017, u paraqitën pranë institucionit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në institucionin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe subjekti u njoftua për fillimin e procesit me shkresën nr. 1819 prot., datë 20.11.2017, “*Mbi zbatimin e Vendimit Nr.132, datë 13.06.2017, “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në datën 12.06.2017, në lidhje me pezullimin nga shërbimi civil të punonjëses \*\*\*\*\*”*”.

Grupi i punës, gjatë vizitës në subjekt komunikoi me njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe verifikoi materialet shkresore të cilat vërtetonin zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në vendimin paralajmërues. Takimi me njësinë e burimeve njerëzore, si dhe verifikimi i akteve dhe dokumentacionit shoqëruar që administrohej nga kjo zyrë dhe zyra e Arkiv-Protokollit, është materializuar në procesverbalin e datës 04.12.2017, të mbajtur nga grupi i punës i Komisionerit dhe personat e kontaktit të institucionit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Pasi u administruan dhe u trajtuan materialet shkresore të vëna në dispozicion, rezultoi se:

Në pikën 1 të vendimit objekt verifikimi, Komisioneri ka kërkuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit të anulojë Urdhrin Nr.327, datë 09.06.2017, “*Për pezullimin nga detyra të Drejtores së Drejtorisë Arsimore Rajonale, Vlorë”*, si një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, duke e rikthyer punonjësen \*\*\*\*\* në detyrën e Drejtores së Drejtorisë Arsimore Vlorë.

Gjatë verifikimit në subjekt rezultoi se punonjësjë \*\*\*\*\* ka vazhduar të kryejë detyrën pa shkëputje pavarësisht urdhrin për pezullimin e saj nga detyra.

Në kushtet kur *de facto* marrëdhënia e punësimit në shërbimin civil të kësaj punonjëseje nuk është ndërprerë për asnjë moment si pasojë e Urdhrit Nr.327, datë 09.06.2017, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, arrihet në konkluzionin se me veprime konkludente, nga ana e Ministrit është pranuar në heshtje pavlefshmëria absolute e këtij akti.

Për sa u parashtrua më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin Nr.132, datë 13.06.2017, “*Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në datën 12.06.2017, në lidhje me pezullimin nga shërbimi civil të punonjëses \*\*\*\*\**”, të Komisionerit, rezulton se situata e ligjshmërisë në thelb është vendosur.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” dhe Rregulloren, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr.132, datë 13.06.2017, “*Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në datën 12.06.2017, në lidhje me pezullimin nga shërbimi civil të punonjëses \*\*\*\*\**”, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse të institucionit Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, nëpërmjet pranimit në heshtje të pavlefshmërisë absolute të aktit Nr.327, datë 09.06.2017, “*Për pezullimin nga detyra të Drejtores së Drejtorisë Arsimore Rajonale, Vlorë*”.
3. Për këtë vendim të njoftohet Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Departamenti i Administratës Publike dhe nëpunësja \*\*\*\*\*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**